



RETROSPEKTIVE

KOLEKSIONI SHQIPTAR

RETRO
KOLEKSIONI SHQIPTAR



22.12.2023 / Nr #2

GËZIM E HARE, "RETRO CHRISTMAS" 2023!



Futemi në botën e magjisë, aty ku fryma e festës ndërthuret me sharmin e dikurshëm. "Retro Christmas" sjell më pranë shpirtin e festave të fundvitit përmes mjeteve historike, të dekoruara me drita shumëngjyrëshe, që ndriçojnë sheshin dhe tërheqin vëmendjen e kureshtarëve duke dhuruar një spektakël emocionesh. "Retro Christmas" është më shumë se një event; është një udhëtim pas në kohë, një festë e traditës dhe një dëshmitar i ngrohtësisë dhe emocionit që përcjell sezoni i festave.

Pulla Shqypniet

"RETRO"

dhurata ma e bukur

e fundvitit për të

apasionuarit e

qerreve me motorr



Pjesëmarrja jonë në "Rallye-n" automobilistik ballkanik 1938

Është me të vërtetë një kënaqësi për vendin tonë kur shohim që në konkurse të ndryshme të marrin pjesë edhe shqiptarë. Edhe në mos fitofshim rekorde në këto raste, mbetet gjithnjë një përfitim moral me rëndësi. Kështu në të dytin "Rallye automobilistik ballkanik" mer pjesë shoferi, i njohur për zotësin e tij, z. Lluka Rashka, i cili nisët sot pasdreke nga Tirana. Nisja do të bëhet përpara Bashkisë. Shqipëria dërgon për të parën herë një konkures të saj në këtë Rally dhe

i detyrohet kujdesit të KTAM-it kjo pjesëmarrje. Na pëlqen kjo nisëtiivë dhe pa tjetër do të pritët mirë prej të gjithë atyre që i japin një farë kuptimi këtyre punëve. Janë përpjekje, të cilat në fushën e tyre, i lënë një emër Shqipërisë. Vend mritjeje e këtij "Rally" është Athina dhe vend nisje janë: Osjek, Brasov, Varna, Istanbul dhe Tirana. E përcjellim konkuresin shqiptar në këtë "Rally" duke shtuar edhe urimet tona.

Gazeta "Drita", 2 Qershor 1938



TARGA SUVENIR

Kushdo që do të bëjë një dhuratë të veçantë, dedikim, personalizim për showroom, zyrë e shtëpi tashmë mund të zgjedhi formën, ngjyrën dhe karakteret e preferuara!

POROSIT ONLINE
WWW.DPSHTRR.AL

RETRO .AL

FESTIVALI I AUTOMOBILIT: PANAIRI AUTOMOTIVE FAIR ALBANIA



Gautam Sen,
Zv. President i FIVA - Fédération Internationale des Véhicules Anciens, gjyqtar në disa konkurse elegance të mjeteve historike, autor, themelues dhe kryeredaktor në revista prestigjioze për automjete, si dhe bashkëpunëtor me mjeshtra të mëdhenj të dizenjimit të automjeteve si Marcello Gandini, Tom Tjaarda dhe Gérard Godfroy, i kushton një artikull eventit të vitit në Shqipëri, Automotive Fair Albania II, në revistën Derivaz & Ives.

Ata premtojnë se do të kishin katër ditë muzikë, makina, motoçikleta dhe çmenduri... dhe kjo ndodhi në edicionin e dytë të Automotive Fair Albania.

I mbajtur në Tiranë, kryeqytetin e Shqipërisë, nga data 26 deri më 29 Tetor, edicioni i këtij viti shpërndau dozat e barabartë të garash me motoçikleta dhe makina elektrike, Porsche GT3 dhe Ferrari moderne, xhiro të shpejta emocionuese në qendër të qytetit në cirkuite 1,5 km, një shfaqje motorësh me 50 ekspozues të veçantë dhe një ekspozitë e mrekullueshme e automjeteve historike, si dhe disa makinave të shkëlqyera historike garash, kryesisht makina garash nga vitet 1950 dhe 1960.

Organizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR) dhe Retro Albania, si dhe Ministria e Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkia e Tiranës, Automotive Fair Albania është një festë e vërtetë e mjeteve, një festival argëtues, i cili kishte rreth 160,000 qytetarë të Tiranës dhe qyteteve përreth saj, duke parë dhe mbështetur ngjarjen katërditore.

Për të marrë makina garash që nuk janë parë kurrë më parë në Shqipëri, Retro Albania dhe

DPSHTRR morën mbështetjen shumë entuziaste të Antonio Durso dhe Old Cars Club nga Bari, Itali, si dhe Porsche Club Puglia dhe Ferrari Club Italia, të cilët kishin udhëtuar të gjithë me traget ose kamion nga Italia në Shqipëri për të marrë pjesë në panair.

Pas "Garës së Kampionëve", 14 makina elektrike - me nga dy shoferë secila - konkurruan në ditën e parë, teksa një Tesla Model Y fitoi garën.

Kjo u pasua nga një seancë emocionuese drithërimash teksa një grup motoristash përshkuan sup më sup cirkuitin e ngushtë 1.5 km.

Unë isha atje në eventin e së shtunës, datë 28, ku rreth 22 Porsche 911 GT3, GTS, Caymans, Boxsters, etj, dhe shtatë Ferrari (disa 599 dhe 458,





Falënderojmë pjesëmarrjen e Klubit të Automobilave në Bari

550, 488 dhe 612) kaluan në cirkuit me sekuenca. Tingulli dhe furia e këtyre makinave GT të racës së pastër emocionuan shumë të rinj e të moshuar.

Por brohoritjet më të mëdha ishin për garuesit historikë dhe makinat sportive që u ngjitën në pistë para tyre. Disa prej tyre ishin mjete një vendëshe ose barchetta me dy vende të viteve 1950 dhe fillim të viteve 1960, të tilla si një Stanguellini elegant, një mjet special me motor Lancia të quajtur De Laval, një Apache, një Scaglietti dhe një Formula Juniors Le Blanc, si dhe një Maserati 150S mbresëlënëse, i cili ishte duke fituar, teksa

navigatori i tij u sigurua që shoferi të mos nxitonte përgjatë kontrollit të kohës.

Makinat sportive që mahnitën spektatorët brohoritës ishin disa Jaguar, një XK150 dhe një E Type, disa MG, një TA e zhveshur dhe një MGA shumë e bukur. Ishin dy makina që më ngatërruan, një Elval dhe një Amblin... por ajo që ma zbukuroi ditën ishte Alfa Romeo 1900 Spider dhe Lancia Flaminia SS Zagato e shkëlqyer me një ngjyrim argjendi shumë elegant.

Një nga krijimet më të mëdha të dizajnit nga Ercole Spada për Carrozzeria Zagato, Flaminia SS

Zagato ishte simbolike pasi ishte vetëm ditën para, të premten më 27, kur kam kaluar shumicën e ditës me legjendën e dizajnit. Ne në FIVA morëm mundësinë për ta pranuar atë në "Hall of Fame" të Trashëgimisë së FIVA-s.

Në qendër të vëmendjes ishte makina e cila është mjeti më i vjetër historik në Shqipëri, një Hupp i vitit 1930, në pronësi të koleksionistit "të turpshëm" ndaj mediave dhe diskret, Enea Dauti. Sibora Xhemali, drejtuese e Retro Albania, ishte me të drejtë krenare që kishte bindur Z. Dauti të ekspozonte mjetin. Huppi ishte jashtë qendrës së ambientit ku po zhvillohej ekspozita kryesore e makinave, e cila kishte rreth 50 ekspozues të makinave dhe motorëve, shumica prej tyre ishin evropiane, si dhe një numër i konsiderueshëm prodhuesish kinezë të makinave.

Retro Albania, në ditën e hapjes së panairit, arriti të mblidhte më shumë se 70 makina historike, ndërsa disa prej tyre u bashkuan përsëri ditën pasuese për paradën e të gjitha makinave - të vjetrat si dhe ato moderne - nëpër qytetin e Tiranës.

Duke përzier historinë me modernen, duke ofruar një ekspozitë të makinave, një shfaqje dhe paradë të mjeteve historike, motorsport, dhe muzikë të vazhdueshme, koncepti i një festivali të mirëfilltë të makinave, bëri Panairin Automobilistik në Shqipëri një ngjarje të shkëlqyer... (Gautam Sen).



RIKTHIMI NOSTALGJIK I HISTORISË:

“Makina e fundit e Mbretit Zog gjen rrugën e saj në Shqipëri”



Makina e fundit që ishte nën drejtimin e Mbretit Zog, një Rover i rrallë nga viti 1949, ka gjetur shtegun për në Shqipëri pas një udhëtimi të gjatë përmes Egjiptit dhe Francës. Autoriteti Portual i Durrësit tregoi disa pamje emocionuese si makina e mbretit u fut në vendin tonë përmes Portit.

Kjo makinë, e përdorur nga Mbreti Zog deri në vitin e vdekjes së tij në Paris në 1961, ka arritur në Shqipëri nën kujdesin e Ambasadës Franceze në Tiranë dhe aktualisht ndodhet pranë koleksionit të relikeve të Park Place Tirana.

Për vite të tëra, makina që ka udhëtuar me Mbretin Zog në Egjipt dhe në Francë ishte në pronësi të një koleksionisti francez, por tashmë, ajo është në Shqipëri, plotësisht e merituar, dhe gati për të ekspozuar historinë e saj.

Ma të bukurat BLUZA
për një verë ma t'bukur!



Bluzat RETRO janë tepër cilësore dhe i gjeni në 5 modele njana ma e bukur se tjetra në dyqanin tonë retro.al



RETRO ALBANIA 2020-2023

Roleksioni historik i mjeteve shqiptare Retro, është pasuria e një epoke që jeton në zemrat rrahëse të atyre që përqafojnë joshjen e së kaluarës. Çdo mjet Retro është një rrëfim në lëvizje e një dëshmi e mjeshhtërisë së automobilizmit, drejt një udhëtimi nostalgjik në kohë, duke mbartur me vete jehonën e një trashëgimie të pasur automobilistike.

Ndërsa festa ndizet në shfaqjet e mjeteve Retro, publiku është i ftuar të jetë dëshmitar i një spektakli që shkon përtej të zakonshmes. Rrugët e sheshet kryesore të qyteteve kthehen në një skenë ku e kaluara përplaslet me hijeshi me të tashmen, duke

ngjallur një ndjenjë kolektive habie dhe admirimi. Vlerësimi i mjeteve historike shkon përtej funksionalitetit të tyre aktual. Ai reflekton pasionin për ruajtjen e trashëgimisë automotive dhe ngritjen lart të vlerave të inxhinierisë së shkuar të automobilizmit, qoftë kjo përmes zotërimit, restaurimit ose thjesht admirimit të mjeteve nga entuziastët.

Të mbështjellë me meloditë tërheqëse të nostalgjisë e nën tingujt Jazz & Swing, Retro na fton për të kremtuar krijimin e një komuniteti që thyen kufijtë e kohës duke u kthyer në një fenomen kulturor që jeton në breza.

Hekuraria "Vezuvi"

Vangjel P. Peristere

Në Hekurarinë t'onë punohet çfarë-do sent hekurli-nash, ndreqen mashinarira të ndryshme, bëhen hekura për ballkone, përmaklleke, shkal'a, penxhere, susta, krevate, krevatka-djep në formë dhe modella europiane të mbërthlyera dhe të qepura me sunbulla prej çingoje dhe të derdhura, me një bukuri ekstra ordinare.

Që të gjitha punohen me mjeshhtëri të mbaruar dhe me garanci.



Automotive Fair Albania

Kujtimet dhe kultura Retro marrin vlerë kur i kthehen publikut, për të jetëzuar trashëgiminë e teknikës dhe mjeshtërisë nga dora e njeriut, nën kujdesin e pasionit dhe dedikimit ndër breza!

Udhëtimi në kujtimet e së shkuarës, krahas ekspozimit të mjeteve historike, përmes linjës muzeale të arkivit të dokumenteve, targave të automjeteve, fotografive të vjetra dhe pjesëve kinematografike të automotorizimit shqiptar, erdhi pranë dashamirësve nëpërmjet hapësirës së dedikuar në panairin më të shumëpritur, Automotive Fair Albania. Në një event kushtuar teknologjisë së fundit automotive, koleksioni Retro Albania ofron një perspektivë të veçantë për vizitorët, duke sjellë pranë tyre mjettet që kanë lënë gjurmë në historinë e automotorizimit ndër vite.



Shoqëria e Automobillave DODGE & GRAHAM BROS.

Automobilla të famëshme në gjithë botën, si nga bukuria ashtu dhe nga shëndetësia. Vatura prej 2-4, 5, 7 veta. Otobys që më 12 gjer më 25 veta. Kamione prej 1,000 gjer më 3,000 killo, dhe të tjera. Shiten me çmime të pa kundërshtuëshme.

Për hollësira më të plota drejtojeni ne agjenti i përgjithëshëm i Shqipërisë z. Kosta Metsis, Korçë.



Eja në Sarandë me RETRO & Saranda Ti Amo

Kthehemi pas në ditët e ngrohta të verës, ku plot histori, ngjyra dhe kulturë, zhurma e motorëve të mjeteve me shpirt, jehoi përtej Sarandës, harmonizuar me freskinë e detit dhe me nostalgjinë e ëmbël që vetëm këto mjete të veçanta dinë të përcjellin! Ndërsa vija bregdetare e shëtitores së



qytetit të Sarandës shndërrohet në një vitrinë të jashtëzakonshme të nostalgjisë së automobilave, duke ofruar kartolinën më të bukur të sezonit turistik veror nën sloganin "Diell, det dhe dashuri", e ku me qindra e mijëra turistë vendas e të huaj njihen nga afër me një anë tjetër të Shqipërisë, atë të pasionit për të vjetrën dhe ruajtjen e trashëgimisë së saj.



Retro Bazaar

Mes joshjes së përrjetshme të artikujve vintage dhe linjave të hijshme të mjeteve klasike, Retro Albania solli për të gjithë qytetarët dhe dashamirësit, sharmin e dikurshëm, aq shumë të dëshiruar nga të gjithë, duke e kthyer Tiranën në Kryeqytetin Evropian Retro! Kthehemi pas në kohë me koleksionin e mjeteve Retro, pazarin e punimeve artizanale, si dhe hapësirën dedikuar traditës



Retro N'Dibër

Në zemër të maleve dhe natyrës së mahnitshme të Dibërës, si asnjëherë më parë rreshtohen mjetet e Koleksionit Historik Retro. Në një qytet me traditë të pasur folklorike, mes syve kureshtarë, ngazëllimit të fëmijëve, muzikës tradicionale dhe motiveve Jazz & Swing, Retro Albania dhe Oldtimer Club Prizren, përcollën një larmishmëri emocionesh në publik. Makinat e ekspozuara përgjatë shëtitores së

Preferoni të gjithë markën e automobilave *Renault* e cila përfaqësohet në Shqipëri prej zotit Petraq Katro.
Ka vetura të vogëla që më 3 gjer më 7 veta, otobus gjer më 40 veta dhe kamione që më 500 gjer më 10.000 kilogram. Shiten me peshin dhe me kështu të përmuajshme.
Çmime fort t' interesaçme. 2



blirave, ndezën zemrat e çdo dibrani dhe gdhendën kujtimet e tyre. Lumturia e fëmijëve në çdo cep të shëtitores, radhët e gjata në punishten e targave suvenir, fotografitë e panumërta, këto dhe shumë të tjera janë detajet që karakterizuan Retro N'Dibër.

folklorike shqiptare si pjesë e identitetit kombëtar e si një aset kulturor. Komuniteti i mjeteve plot stil, në kuadër të anëtarësimit në Federatën Ndërkombëtare të Mjeteve Historike (FIVA), përçoi në formën më të bukur frymën e viteve '50-'60-të, për të gjithë nostalgjikët dhe dashamirësit e motiveve klasike e tradicionale, për të jetëzuar edhe njëherë çdo kujtim, ndjeshmëri e pasion.





Retro N'Sokak

Mes mureve historike të Gjirokastrës, Retro Albania bëhet pjesë e skenografisë së qytetit të gurtë, i njohur për sokaket e tij me kalldrëm, dhe siluetën karakteristike të kështjellës hijerëndë. Në sfondin madhështor të kësaj feste automobilistike, Retro Albania sjell koleksionin e mjeteve historike shqiptare më të veçanta, ku çdo mjet është një relike që mbart thelbin e epokave të shkuara. Detajet klasike të mjeteve historike ndërthuren mjaft mirë me elementet e së shkuarës, ndërtesat e shumta historike, pazarin e vjetër, kafenetë tradicionale me aromën e veçantë të qytetit me historinë e gdhendur në gurë, duke ia shtuar akoma më shumë hijeshinë. Plot atmosferë nën tingujt muzikorë, Retro N'Sokak solli për entuziastët, të apasionuarit, nostalgjikët, qytetarët dhe turistët, një fundjavë magjike plot pasion dhe energji pozitive, duke jetuar gjatë në kujtimet e qytetit.



Retro N'Shkodër

Pasqyrimi i historisë në rrugicat plot jetë të Shkodrës, së bashku me stilin dhe elegancën e mjeteve historike të ekspozuara, nën petkun e stilit të viteve '30-të, ndezën qytetin plot ngjyra dhe stil. Në rrugicën historike G'juhadol, nën ngrohtësinë e muzikës së përzgjedhur, në një festë të kulturës,



stilit dhe elegancës, Shkodër locja përjetoj çaste magjike deri në orët e vona të mbrëmjes, duke përforcuar krenarinë dhe trashëgiminë kulturore të qytetit, si edhe duke frymëzuar një dashuri të re për nostalgjinë e viteve të shkuara. Por, nuk përfundoi me kaq! Festa vazhdoi në Shirokë, ku mjetet e rreshtuara u nisën në një paradë drejt peizazhit piktoresk, për të vijuar mes njerëzish qeflinj dhe dashamirës të së bukurës e së vjetrës.



Pranvera n'RETRO po vjen!

Prej vitesh tashmë, i japim mirëseardhjen pranverës nëpërmjet paradës dhe ekspozimit të mjeteve klasike, të cilat e kthejnë qytetin në një oaz të ngrohtë, e ku rrezet e ngrohta të diellit pranveror rrëshkasin plot hijeshi mbi mjetet plot stil. Në një atmosferë plot ngjyra dhe ngazëllim, ku muzika buçet dhe çdo lloj grupmoshe del rrugëve të Tiranës e Elbasanit për të festuar, Retro Albania vjen aty për të përcjellë një frymë të re dashurie, atë të dashurisë për të vjetrën, të bukurën, stilin dhe elegancën, të cilat nuk humbasin asnjëherë.



Arrijtën Biçikletat e modelit të fundit "LEGNANO,"



Këjo markë është njohur për materialin të qënaruësëm uksi dhe shumë të lehta në ecje, e preferohen në GJITHË BOTËN — Gjithashtu kemi sjellë material "Sporti, gjithë farësh të njohura në vëndin t'onë — Çmimet e Biçikletave dhe e materialit janë jashtë çdo konkurrence Vizitoni Magazinën Sportive

RUDOLF P. GURASH,
Rruga Fisiharit Nr. 8 — TIRANË



FOTO Marubi, 1897 Shkodër

QYTETI I BIÇIKLETAVE

Mbase jo të gjithë ju që po lexoni këtë shkrim e dini se në Europë jeton një qytet që lëviz mbi dy rrota: është Shkodra, një qytet verior në Shqipëri. Shumë i lashtë, sa daton XXV shekuj më parë. Ka qenë kryeqytet i mbretërisë ilire, por që kur lindi e u zhvillua, unë do të thosha, edhe kryeqytet i mrekullive natyrore: ka fusha, kodra e male, ka tre lumenj Drini, Buna e Kiri që i qëndrojnë si brerore. Kështjella me gurë ciklopik e që sundon tërë relievin, që nga bregdeti Adriatik e deri në Alpe, ka në “themel” një legjendë impresionuese të nënës që muroset në mënyrë që të mos shembet kurrë! Mbase këto burime natyrore patën shtuar në rrjedhë të shekujve edhe lakmitë e pushtuesve.

Por ne në këtë shkrim nuk do të merremi me aspektin historik e gjeografik, por dhe të asnjë fushe tjetër gjurmëlënëse; do u paraqesim një dukuri të rrallë, mbase dhe në Ballkan, pasi Shkodra është një qytet që lëviz mbi dy rrota. E kuptueshme tani për lexuesin, një qytet që lëviz mbi biçikletë, edhe falë faktit se ku ai popullohet është i sheshtë, 12 km i

gjatë dhe rreth 6 km i gjerë, e kështu mjaft praktik për pedalim, aq sa jo pak kronistë, shkrimtarë e gazetarë e kanë quajtur atë “Qyteti i biçikletave”, një model i transportit ekologjik, sidomos tani kur mbi qytete nuk enden retë që sjellin shi, por retë e smogut që të asfiksojnë.

E ka kaluar shekullin që kur në Shkodër u pa të lëvizte rrugëve të saj, sa me kalldrëm e sa gjithë pluhur, një i huaj me një mjet që s’kishte parë asnjë vendali i padalë jashtë shtetit. Kalendar i fiksonte vitin 1907. Ai qe konsulli i nderit i Suedisë, ndaj edhe kush e dëgjoi, u dynd andej nga rruga kryesore ku ai lëvizte që ta shihte me sy atë mjet që ecte mbi dy rrota pa u tërhequr nga kafshët. Me kaq, kurioziteti u shua, po s’u shua lakmia për ta pasur një mjet të tillë udhëtimit dhe kush qe më i kamur e më i dalë jashtë Shqipërisë, nuk ngurroi të sillte biçikleta të markave të ndryshme, më së shumti italiane. Por në kuadrin historik na duhet të përmendim edhe një foto të dy burrave me biçikleta, të nxjerrë nga fototeka “Marubi” e vitit 1897, me veshje kombëtare shqiptare, por që nuk

janë të evidentuar se kush janë për t’i dhënë më vërtetësi kohore asaj. Fillimisht biçikleta në qytetin tonë u quajt “Velisipet”, por edhe dyrrotullake.

Shkodra, ky qytet që besonte në tri fe: myslimane, katolike dhe ortodokse, Shkodra - kjo pioniere e thujse të gjitha fushave të artit e të kulturës në Shqipëri, pati edhe anën tjetër të medaljes: gruaja qe e mënjanuar nga jeta e shoqërisë, fanatizmi bënte punën e tij, ndaj dhe një ditë, si pas një kushtrimi, qytetarët u dyndën sërish nga rruga kryesore ku po kalonte... një grua mbi biçikletë. Dhe ajo nuk qe shqiptare, por një grua e konsullatës austriake. Edhe pse biçikleta nuk kishte fituar “qytetarinë” e plotë, ajo po kuptohej sikur ishte krijuar enkas për këtë qytet, aq sa policia vendore që në vitin 1915 u pajis e nisi të pedalojë me biçikleta. Me shtimin e numrit të biçikletave, një grup qytetarësh shkodranë vendosën të krijojnë sportin e çiklizmit që në vitin 1920. Rrethi i parë çiklistik, që është edhe i treti në Europë për nga vjetërsia, pas Francës e Italisë, është organizuar pikërisht në qytetin tim. Ndaj dhe në vazhdimësi Shkodra ia ka dhënë tonin këtij sporti, aq sa jo vetëm të rriturit, por nuk ka fëmijë që të mos dijë të ngasë biçikletën. Duke pasur parasysh se deri në dekadat e para të shekullit XX shtëpitë shkodrane ishin një dhe dykatëshe e rrallë trekatëshe, se shumica prej tyre kishin oborre e haure, mundësia e mbajtjes dhe e lënies së biçikletave ishte e jashtëzakonshme. Ato erdhën nga viti në vit duke u shtuar, por si gjithnjë, deri në çlirimin e Shqipërisë nga nazifashistët më 29 nëntor 1944, biçikleta qe privilegj i burrave e djemve. U arrit deri atje sa të kishte dhe një “konkurrencë” se kush të kishte biçikletën më të bukur. Zhvillimi i Shkodrës, krijimi i një zone industriale jashtë vijës së verdhë të qytetit, e bëri biçikletën një mjet pune të domosdoshëm, jo vetëm për burrat, por edhe për vajzat e për gratë, aq sa, në aneksin e stadiumit të qytetit e në fusha të periferisë shihje vazhdimisht me dhjetëra femra duke mësuar pedalimin në biçikletë.

Qe një kohë kur qarkullimi nga shtëpia në qendrën e punës nuk përballohej dot nga 2-3 autobusë urbanë, kur askush, veç pushtetarëve të lartë vendorë e qendrorë, nuk kishte mundësi të udhëtonin me vetura, biçikleta qe zgjidhja e vetme, edhe pse kërkesat në rritje nuk plotësoheshin dot nga importimi i tyre (fillimisht nga vendet e Lindjes e më pas nga Kina). Me biçikleta dilnin në punë mjekët e mësuesit, mjeshtrit e çirakët, inxhinierët e artistët, nëpunësit e ushtarakët, etj.

Nga fundi i viteve ‘50 të shekullit të kaluar, kur Shkodra kishte kund rreth 60 000 banorë, ka të dhëna të plota se në qytet numëroheshin mbi 10 000 biçikleta. Ishte koha kur edhe biçikletat regjistroheshin dhe çdo qytetar, ndaj një pagese simbolike merrte një llamarinë me fushë të bardhë sa një celular mesatar ku kishte të stampuar numrin, që ishte i detyruar ta vendoste nën shalën e biçikletës. Pat njerëz të fiksuar pas numrave, aq sa në Shkodër dihej se violinisti Kolë Vjerdha kishte gjithnjë numrin 1, se Nazmi Mandia e Kel Temali qenë ndër të parët që pedalonin mbi biçikleta, se ai që e mbante “Bianchi-n” e tij edhe pse e përdorte prej disa vitesh si të kishte dalë atë ditë nga fabrika, se Faik Quku, instrumentist i njohur i ahengut shkodran, se Fadil Kruja e Ragip Curri qenë ndër të parët që futën në Shkodër biçikletën dyshe, se Mark Mirashi, sapo mori diplomën si kirurg bleu një “Mifa” e me të doli në pension, etj. Shkodra kishte më shumë se çdo qytet tjetër shqiptar reparte e dyqane të riparimit të biçikletave, pasi nevoja për

to, edhe në kushtet kur jo të gjitha rrugët qenë të asfaltuara, qe e madhe. Janë të njohur në Shkodër mjeshtrit biçiklistë, si Qazim Damnori, vëllezërit Kallugjeri, Sadetin Ulqinaku, Enver Kosova e shumë të tjerë.

Një dekadë më pas, ndërmarrja e re e punimeve artistike, me afro 3 000 punëtorë, kishte në sheshin para zyrave e reparteve çdo ditë mbi 1 000 biçikleta, ku vajzat e gratë shkodrane shkonin e dilnin nga puna. Pas përmbyesjes së sistemit të kaluar, në vitin 1991 e deri më sot nuk mund të themi se është e njëjta statistikë, edhe pse qyteti për nga ana demografike ka shënuar rritje të ndjeshme. Kjo për arsye se zona industriale që numëronte dhjetëra mijëra punëtorë u asfiksua dhe shumë ndërmarrje u mbyllën. E nëse deri dje qyteti ecte plotësisht mbi dy rrota, sot ai ndoshta në të njëjtat raporte ecën mbi katër rrota, mbi makina të markave të ndryshme, aq sa sidomos në rrugët kryesore veç në mesnatë mund të gjesh vend për parkim. Por gjithsesi, Shkodrës askush nga qytetet shqiptare nuk ka mundur t'ia heqë nga koka kurorën e kampiones së biçikletave. Sërish me mijëra të tilla qarkullojnë arterieve të tij. Autori i këtij shkrimi, aq i dashuruar pas zhvillimit e së resë, nuk ka bërë "kompromis" e as ka provuar të marrë patentën e makinës, pasi siç them sot me humor, "nuk kam ndërmend ta ndërroj "Benz"-in tim, që është një biçikletë e markës gjermane, as me "Benz"-in e vitit 2013!". Të impresionon fakti që Jozef Zualleart, një njohës nga më të azhurnuarit e pedalimit me biçikleta në Europë, në një studim të vitit 2011 e dallon Shkodrën si qytet rekord në Shqipëri, madje në Europën Juglindore dhe atë Qendrore, me një përqindjeje të lartë pedalimi prej 29%. Ajo renditet mes qyteteve europiane të njohura për kulturën e lartë pedaluase, të tilla si: Bolzano, Ferrara, Fraiburg, qytetet e Vendeve të Ulëta dhe Vendeve Skandinave. Krijimi në Shkodër i një organizate jofitimprurëse, e quajtur 'GO2' [shko me 2 këmbë dhe mbi 2 rrota] me fokus lëvizjen urbane të qëndrueshme, ndër të parat në llojin e vet në Shqipëri dhe mbështetja që ajo ka gjetur nga pushtetarët vendorë e banorët, flasin se pedalimi me biçikleta do të fitojë terren e do të vijë duke e pasuruar përvojën e saj të hershme me elementë bashkëkohorë. Lëvizja e Shkodrës mbi dy rrota ka inspiruar edhe poetin Mehmet Guçia, lëvruesi i parë dhe më i suksesshmi i hajkut japonez në këtë qytet. Ai ka në dorëshkrim një vëllim me 100 hajke, kushtuar biçikletës në Shkodër. E për të shuar kureshtjen e lexuesve të këtij shkrimi, po sjellim dy hajke, njëra prej të cilave i kushtohet poetit më modern të shekullit të kaluar, Migjeni, i cili sa qe mësues në Vrakë, rrugën nga Shkodra në

këtë fshat e kthim disa kilometra e bënte përditë me biçikletë: Përballë murlanit/Nuk ndalet biçikleta./ Është Migjeni dhe: Shoh nga Rozafa/ Udhën nga valon Buna: Lumë biçikletash! Sot përditë e më shumë pranë institucioneve e ndërmarrjeve, ndanë pazareve, stadiumeve e fushave të sportit sheh jo me dhjetëra, por edhe me qindra biçikleta të parkuara; në ditët pa shi, me biçikleta, plot familje apo grupe shoqërore bëjnë ekskursione deri në Shirokë e Zues e tek Ura e Mesit, disa kilometra larg qendrës së qytetit. Dashuria për pedalimin mbi biçikletë u rrënjësohet fëmijëve që të vegjël, aq sa kush është familjar, para biçikletës do të ketë edhe një kosh ku vë fëmijët e moshës 2-5 vjeç dhe me të shëtit rrugë më rrugë.

Sot në Shkodër ka disa markete ku shiten biçikleta të tipeve të ndryshme, por edhe pjesë këmbimi për to, ka një lëvizje sociale për të shtuar

numrin e përdoruesve të biçikletave, aq sa u arrit deri atje sa të tërhiqej vëmendja e opinionit e në prefekturën e Shkodrës të organizohej simpoziumi i parë ndërkombëtar mbi lëvizjen e qëndrueshme, më tetor 2012. Por kjo lëvizje merr përmasë e kuptim të ri, kur që nga kryetari i bashkisë e deri tek presidenti i një firme, që nga deputeti e drejtori i gjimnazit, që nga nëpunësi e ushtaraku të shkojnë në zyrë me biçikletë, jo sa për të dalë në një foto. Pse jo, në një shesh kryesor, biçikletës t'i ngremë një monument, pasi ajo ka qenë bashkudhëtare e jetës që prej një shekulli e këndeje e të mos mjaftohemi me vendosjen e një skeleti të saj në një rrethrotullim të qytetit.

* SKËNDER TEMALI

* Shkrimtar, Shkodër



TRAJSET
"RETRO"
KAHERA
NË MODË

**HOTEL-BUFFET
CENTRAL**
Ish-Hotel Durrës
NË QENDËR TË TIRANËS
Dhoma të pastra me diell
Pijat më të zgjedhura me Mezet
më të Shija
Chambres Séparées
04 NIKOLL SILIQI

SHOFERËT DHE RRUGËT



Po i ngjitemi një rrugë të re malore. Është njëra prej atyre rrugëve që ende nuk figurojnë në hartat e reja të Shqipërisë.

Udhëtojmë me Skodën 02-93 që drejtohet nga shoferi Dhimogjen Zero, i parkut të Tiranës. Rruga përshkon Mirditën dhe kalon herë në të djathtë e herë në të majtë të Fanit. Ky lumë kurdoherë i rrëmbyeshëm ka krijuar këndeje lugina të thella, të cilat kur i sheh nga rruga automobilistike të duken, ashtu siç janë në të vërtetë, humnera të rrezikshme. Këtë e vëren sidomos kur kamjonit me të cilin udhëton, i duhet t'u hapë rrugën maqinave që zbresin ngarkuar, atëhere rrotat prekin gurët e spondit të rrugës, e ty të duket sikur një pjesë e kabinës qëndron në hapësirë. Mund të të pushtojë edhe ndjenja e rrezikut. Por kjo të largohet shpejt, sapo vëren qetësinë e zakonshme të shoferit dhe atë të shokëve të tij, me kamjonët e rëndë që kalojnë nëpër këto "ngushtica", thuhetse pa u trazuar fare.

Shiu që filloi në mëngjes, vazhdon të bjerë i dendur. Ecim drejt Shupalit dhe Repsit; nëpër rrugën e re që të çon në Fan e Orosh. Kjo është e vështirë dhe pendenca e sajë, e prirë aty këtu nga ana e jashtëme, krijon rrezikun e rrëshqitjes. Kujdesi i madh i shoferit në këtë rast, përqëndrimi i zakonshëm i vemendjes së tij dhe gatishmëria në manovrim, përbëjnë një lodhje tjetër, ndoshta më të rëndë se lodhja fizike. Këto, e shumë telashe e vështirësi të tjera përballohen me qetësi dhe me një natyrshmëri të çuditëshme. Edhe kjo tregon kalitjen e këtyre njerëzve.

Në Reps, automjetet e parkut të Tiranës ngarkojnë trupa për gatrat e Laçit. Edhe këtu, në këtë fshat dikur krejtësisht të humbur, po krijohet një qendër e re pune e banimi. Punëtorët e palodhur të ngarkimit, shpejtojnë që kamjonët të nisen pa rënë nata. Por shiu, e tani së fundi mjegulla e vështirëson edhe më tepër parën.

Koha vazhdon të jetë e njëjtë edhe tani që po i ngjitemi Spaçit të ri, që shtrihet në këmbë të Munellës 1990 metra. Duke iu afruar malit ndjejmë edhe ndrrimin e klimës... Të ftohtit shtohet i shoqëruar edhe me një erë të fortë. Kjo rrugë ka trafik të dendur automjetesh, ka edhe këmbësorë. Disa ecin drejt, pa u ndalur. Të

tjerë që, siç duket banjonë larg, ngrënë dorën që maqina të ndalet. 02-93-shi kishte një vend të lirë dhe u ndal të marrë një fshatar.

Shpesh qëllon që shoferi me udhëtarin të njihen mes tyre, ashtu siç ndodhi edhe me shokun që sapo hipi.

Këta ishin njohur fare rastësisht, në rrugë. Por ishin miqësuar. Shoferët e parkut të Tiranës punojnë tranzit në këto anë, prej disa vjetësh. Mjaft prej këtyre shkuan të parët në ato fshatra ku arriji rruga e re automobilistike. Festuan bashkë me fshatarët ardhjen e maqinës së parë të cilën malësorët e quajtën edhe "e dërguara e Partisë".



Zotimet e muajt të sulmit për 13 rrugëshin i kryenë para afatit edhe shoferët Enver Murati e Sadik Gjasi, të cilët dalohen edhe për mirëmbajtjen e automjetit.



Që atëhere, shoferë e malësorë shihen gjithnjë e më shpesh, me njëri tjetrin. Kështu kanë krijuar edhe këtë miqësi të re, socialiste. Se sa e çmon këtë miqësi malësori ynë, e tregojnë edhe rastet kur ai, mes tufanit me borë ka vënë edhe jetën në rrezik "për të shpëtuar këta djem, që- siç na tha një vëndas - në këto malet tona, venë në jetë fjalën e partisë".

Spaçi ka lindur aty në një shpat të malit, aty edhe po zhvillohet, po shtrihet. Çdo gjë është e re e bile fare e re. Edhe rruga që kalon këtu, mes qytetit të minatorëve, është gjithashtu e re, por kjo të le një përshtypje të keqe. Thuaj se s'kujdeset njeri për të. Ajo kalon fare pranë drejtoris së minierës, përshkon, si të thuash oborrin e saj dhe tamam aty është me gropa si hendeqe dhe me pendencë të rrezikshme. Diku aty janë ndalur edhe dy "Zis-et" e shoferëve të palodhur Ilo Çipi e Linan Bido.

-Shyqyr që është gjë e vogël e pa rëndësi- flet me zë të lartë një shofer i tretë, që ndalet për të ndihmuar shokët - Sepse këtu, mor vëlla, mund të thyhesh kur të duash, balestra, kryqe e diferenciale dhe te mbetesh në vend. Drejtorinë e këtushme, të Kurbneshit dhe atë të mirëmbajtjes në Ministrinë e komunikacionit do t'i tundte nga vendi vetëm një fletë-rrufe e fortë ose një letër "Zërit të Popullit".

Shoferi që foli kështu, ka plotësisht të drejtë. Në këtë rrugë has kudo me punën e palodhur të shoferëve por, shumë rrallë takon me punën e mirëmbajtësve të rrugëve. Ku jane këta? Në trekëndëshin Spaç-Reps-Kurbnesh, ka rrugë të vështira të cilat, gjatë trafikut të dendur janë bërë dhe shumë të rrezikshme për jetën e njerëzve dhe për maqinat të cilat dëmtohen rëndë. Në këtë trekëndësh ushtrojnë funksionet edhe tri drejtoritë e përmendura më sipër, të tria këto ngarkohen me përgjegjësi për gjëndjen e rrugëve. Por, le të ndjejnë përgjegjësinë e tyre edhe drejtuesit e NTASH-Mallrave të cilët, bazën mekanike ku riparohen automjetet në fshatin Ndëfushë, e kanë lënë krejtësisht në natyrë, pa asnjë strehë apo kapanon. Ka afro një vit e gjysëm që ata përdorin të njëjtën shprehje: "e kemi provizore, mund ta shpërngulim". Ky është lajtmotivi i burokracisë dhe indiferentizmit. Ndërsa xhenerikët e palodhur e me shpirt



sakrifice vazhdojnë të punojnë pranë automjeteve nën shiun, dëborën dhe erën e forte.

Mbas një ngjitjeje të vështirë arritëm në pikën numër një të ngarkimit të mineralit. Dy tramoze, njëra me bakër e tjetra me piritin e çmuar për Uzinën e superfosfatit të Laçit lëshohen mbi karrocëritë e kamjonëve. Çdo gjë këtu eci me ritmin e duhur. Shoferi hipi edhe

në karrocieri për të rregulluar shpërndarjen e peshës. Por, shiut të parreshtur dhe të ftohtit tani iu shtua edhe errësira e plotë. Në këtë errësi po fillon të kryhet edhe "operacioni" i kthimit. Mos u çuditni që përdorim këtë shprehje. Është me të vërtetë operacion. Automjetit të rëndë u duhen gati 20 minuta të ecë para e prapa, në 2-3 metra vend, me stercime të forta, me një sforcim të madh të motorit. Shpesh herë rrota e jashtme i qëndron pezull mbi greminë. Kush e merr përgjegjësinë në se, për një difekt në sistemin e frenimit maqina rrëshqet duke shkakuar viktima edhe ndër banorët e shtëpive të ndërtuara në atë shpat mali? Drejtori i minierës, shoku Pal Marka Deda ngushticën e jashtëzakonshme të vendit e paraqet si "pasojë e grumbullimit të mineralit..." A mund të vazhdohet me arsyetime të tilla? Në se është ashtu, përsëri nuk zgjerohet edhe më shumë sheshi pranë tramozheve që të zërë edhe mineral rezervë?

...Tani Shupalin e lamë pas dhe kamjoni rrëshqet mbi asfalt, shpejt dhe pa tronditje. Timoni lehtësohet menjëherë. Shoferi merr frymë lirisht. Ai shkri krahët dhe sheh orën.

-Ka kaluar nga shtatë! Shtatë! Dita na kaloi në rrugë. Dita po mbyllet ngadalë me shi, ashtu siç u çel. Të gjithë e kuptojnë këtë. Por, ndërsa ne e masim kohën vetëm me orët apo me diellin, shoferët e masin me rrugët që kanë kryer, me planin, e së fundi, me lodhjen e tyre.

Dhiogjeni më thotë:

-Puna jonë ndryshon nga punët e tjera. Ne e mbyllim ditën e punës kur lodhja e nevoja për gjumë të kapisin, kur s'bën dot më tej... Atëhere ndalemi aty ku ndodhemi. Ose diku më tej, në një vend të mbrojtur nga era. Sigurojmë maqinën, ulim shtratin që kemi në kabinë dhe flejmë. Kjo ndodh në orën nëntë ose dhjetë të mbrëmjes.

-Dhe kur e filloni ditën e punës?

-Zakonisht në orën katër të mëngjezit.

...Sot është dita e dytë. Ecim drejt Kurbeneshit. Vargu i "Skodave" dhe "Zisëve" është përsëri në lëvizje. Shoferët këmbëjnë përshëndetjet e ditës së re.

"Mirëmëngjesi" i tyre bëhet me një të ngritur të dorës, me një buri ose vetëm me buzëqeshjen e tyre të çiltër. Në rrotat e maqinave sot nuk kanë vënë zinxhirët. Sot nuk ka ngrirë dhe nuk fryn tufani i egër me dëborë i disa ditëve më parë. Megjithatë, në kabinën e 02-93-shit biseda vërtitet pikërisht rreth dimërit, rreziqeve, vështirësive, shpirtit të sakrificës që kanë shoferët ndaj detyrës dhe shokëve. Sot po udhëton me ne edhe oficeri i autoinspektoriatit Mëno Dedaj.

-Nëqoftëse rrugët nuk u zunë sivjet - thotë ai - megjithatë akullin dhe borën e madhe, kjo u kushtohet vetëm këtyre shoferëve. Këta çanin me guxim përpara, hapnin rrugët pa humbur lidhjet me njëri tjetrin.

-"Pret Laçi - thoshin, pret Rubiku, pret atdheu!" Dhe asgjë s'i ndalte. Atëhere ta shikojë Esat Sulën si ndihmonte shokët; si i tërhiqte në akull dhe çbllokonte rrugët; Medai Askushin, Panajot Vllahon, Petrit Fortuzin, shoferin e mekanikun e zotë.

-Këta - u hodh e tha një punonjës i prokurorisë së Rrëshenit - ne i thërrasim shkurtimisht, vetëm me një emër : revolucionarë.

Diku buzë Fanit na tregojnë një vend ku, në ato ditë ngricash të mëdha u batua shoferi Mihal Koka me targën 15-39.

Fajin e kishte akulli. Kabina u shtyp, trupi i


shoferit mbeti i bllokuar nën peshën e rëndë të motorit, timonit dhe hekurave. Koka iu izolua nga kruskotoja, ai me zi merrte frymë, me zi duronte të ftohtit e madh. Por Mihalin e shpëtuan shokët, Thoma Puleri, Bahriu, Rexhepi, Shefqeti dhe shoferi guximtar Minella Golemi.

Rruga kalon pa u ndjerë, duke dëgjuar ngjarje të tilla. Në çdo njëren prej tyre ka heroizëm, edhe kur këto tregohen me një ton humoristik.

Poshtë, në të majtë, në pllajën e malit shtrihet qyteti i ri e i bukur i Kurbeneshit. Është ngritur mbi një reliev të vështirë. E vështirë është edhe rruga që të çon në vendshkarkimin e fabrikës së pasurimit të bakrit. Ngjitja bëhet me marsh së prapmi e të duket sikur kjo copë rruge është bërë qëllimisht për t'u matur me zotësinë e shoferit tonë, me shkathtësinë dhe durimin e tij.

Revista "Ylli", 4 Prill 1968

Një libër me foto dhe kureshtje mbi maqinat historike "RETRO"



NGA ËNDRRA NË REALITET "Nisja e Projektit për Makina Artizanale në Shqipëri"

Kadri Manaj, një inxhinier i ri në moshën 30 vjeç, ka shndërruar një pasion të hershëm në një sfidë që mund të çojë në hapjen e kompanisë së parë shqiptare të ndërtimit të automjeteve artizanale. Nisur nga koha e adoleshencës, ai ka filluar të ndërtojë makinën e tij të parë në moshën 13-vjeçare, duke shkëlqyer me vizionin dhe aftësitë e tij.

Kadri është pjesë e një panairi të mjeteve historike "Retro N'gaz" në fillim të nëntorit, ku makinën e tij, modelin Lotus, e ka ekspozuar për publikun. Makina e tij ka tërhequr vëmendjen e shumë të rinjve dhe entuziastëve të mjeteve historike për shkak të detajit të tij unik.



TELETRANSPORT PAS NË KOHË?!

Kështu është të zbulosh hapësirat e Muzeut "Ron", kthim pas në kohë nëpërmjet koleksionit që mbledh automjete, motomjete, objekte historike të automotorizimit shqiptar dhe aspekteve të tjera jetësore për një shtrirje të gjatë kohore që nis prej viteve '20-të.

Ky show room krijon një panoramë të bukur për t'iu rrëfyer brezave të rinj me gjithë dinamizmin e vetë.

Prapa çdo elementi e çdo mjeti historik qëndrojnë: Arben Prrenjasi, një nga koleksionuesit më të mirënjohur të mjeteve historike në Shqipëri, me dëshirën e tij të pashtershme për të lënë si trashëgimi këto vlera historike. Gjithashtu Medi Halili, mjeshtri i palodhur që me kontributin e tij teknik, i ka sjellë në formë optimale këto mjetet dhe çdo ditë i mirëmban me dashuri e i ruan me fanatizëm. Vetëm mjeshhtëria e këtyre artistëve mund t'i ndizte mjetet historike të periudhës në këtë formë kaq unike.



Enea Dauti, një kampion i pasionit për makinat klasike! Prej 15 vitesh tashmë si një koleksionist i apasionuar pas mjeteve të epokës, pjesë të koleksionit të tij radhiten mjetet e rralla si "Buick Super Eight" - 1951, "Hupmobile 4dr" - 1930, Cadillac Eldorado 8.2 - 1970, Lincoln Continental 5.0 - 1979, Mercedes Benz S Class 220 - 1959, etj.

Pasionin e dëshirën për rijetësimin e këtyre mjeteve, ka arritur t'a "eksportoje" edhe në evente jashë Shqipërie, ku me mjetet e tij të treguara me targa historike shqiptare, ka udhëtuar lehtësisht për të marrë pjesë në evente "vintage" europiane. Ndërkohë që angazhohet në evente të komunitetit Retro, nuk i lë asnjëherë pa "u parkuar" tërë elegancë e hijeshi "dashuritë" e veta, duke ndarë njohuri të vlefshme dhe pasion me entuziastët e tjerë.

Përmes koleksionit dhe fanatizmit të ruajtjes së tyre, ai përjetëson dhe promovon trashëgiminë e "makinave me shpirt", me mani për detajet dhe historinë individuale që mbartin secila prej tyre, e që frymëzon edhe brezat e rinj me po të njëjtën dëshirë e kujdes ndaj ruajtjes e përcjelljes së kulturës automotive.



Gusht 2022

Luiza Gega, Kampionia e Europës kthehet në atdhe e shoqëruar nga Cadillac Eldorado Big Block, 1973



AUTOBUSAT NË SHQIPËRI NË VITIN 1987

Tronikë e një fundjavë të gjatë në rrugët Shqipërisë në vitin 1987 më mundësoi të shihja se si ishin shërbimet e transportit publik në një vend ku pronarët e makinave private ishin të pakët. Pas një udhëtimi nga Londra në Titograd, një autobus i linjave ajrore jugosllave na çoi në kufi, ku duhet të ecje për të bashkuar me autobusin tonë të udhëtimit në Shqipëri. Ky ishte një Kassbohrer Setra 110, shumë mirë mirëmbajtur, dhe i vetmi i llojit të tij i vërejtur në flotën e AlbTourist. Shumica e autobusëve të tjerë ishin FIAT ose Skoda.

Nata jonë e parë u kalua në Shkodër, ku vëzhgimet gjatë mbrëmjes dhe mëngjesit pasues treguan një gamë të përzier të Skodave të vjetra, ndonjëherë me prerëse, së bashku me disa autobusë të lidhur prej vijave të panjohura, dhe me livery të ndryshme. Të gjitha qarkullonin me kapacitet të plotë, siç pritej në një vend ku alternativa tjetër ishin vetëm biçikleta ose ecja. Kafshë si kuajt dhe gomarët ishin të shpeshtë.

Të tjerë qytete që vizituam ishin Durrësi dhe kryeqyteti, Tirana, por autobusët në të dyja vendet ishin shumë të ngjashëm me ata në Shkodër. Në Tiranë, një mjet i ngjashëm me kamion tërhiqte një vagon pasagjerësh të madh (të ndërtuar në vend) që dukej se po përplasej. Për më tepër, disa FIAT-e në Tiranë dukej se ishin makinat urbane italiane të mëparshme. Megjithatë, ngjarja më e interesantë lidhur me autobusët në Durrës ishte kur një autokollonë prej dhjetë autobusësh tipikë komunal francez, ende me targa dhe reklama franceze, dolën nga parku dhe formuan një autokollonë (me eskortë policie) për udhëtimin për në Tiranë. Ne i ndoqëm me Setran tonën pas drekës dhe vumë re se një autobus kishte ndalur në fillim, dy të tjerë ishin ndaluar në rrugë, por shtatë të tjerë po ecnin me stil, me eskortën policore përpara. Ata kishin targa franceze '69' dhe mund të ishin nga Lyon-i. Pa dyshim, ata do të ishin një shtesë



e rëndësishme dhe e mirëpritur në kryeqytet si modeli më modern i prezantuar atje.

Këto udhëtime të gjata në fundjavë nga "Voyages Jules Verne" të Londrës ishin të një

çmimi të arsyeshëm, duke mirëpritur ata që donin të kalonin kohë përveç vizitës së pamjeve ose muzeve. Asnjë kundërshtim nuk u bë ndaj fotografisë.

RETRO ALBANIA BËHET ANËTARE E FEDERATËS NDËRKOMBËTARE TË MJETEVE HISTORIKE (FIVA)



Retro Albania, iniciativa vendase që synon të promovojë dhe ruajë trashëgiminë e automobilizmit historik shqiptar, ka shënuar një hap të madh drejt skenës ndërkombëtare të mjeteve historike. Në datën 19 Nëntor 2022, Retro Albania u bë zyrtarisht pjesë e Federatës Ndërkombëtare të Mjeteve Historike, një bashkësi që përfshin 109 shtete dhe një flotë të përgjithshme prej mbi 1.5 milionë mjeteve koleksioni.

Delegacioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), enti themelues dhe përkrahës i Retro Albania, mori pjesë në Asambleenë e Përgjithshme të FIVA në Sofie, Bullgari. Ky event, që u mbajt në një qytet të pasur në histori dhe kulturë, shënoi një moment të veçantë për komunitetin

e mjeteve historike në Shqipëri.

Presidenti i FIVA, Z. Tidde Bresters, në këtë aktivitet solli mesazhin e zyrarizimit të anëtarësimit të Retro Albania në këtë federatë të rëndësishme ndërkombëtare. Njoftimi zyrtar i hyrjes së Retro Albania në FIVA me të drejta të plota është pritur me kënaqësi dhe mirënjohje nga komuniteti i mjeteve historike në Shqipëri.

Ky anëtarësim i shpejtë, realizuar brenda vetëm tre vitesh nga lindja e Retro Albania, është një dëshmi e qartë e përkushtimit dhe përpjekjeve të vazhdueshme të ekipit që drejton sektorin Retro. Ai gjithashtu shënon pasionin e zjarrtë të komunitetit shqiptar të mjeteve historike për të ruajtur dhe promovuar kulturën e mjetit historik.

DPSHTRR, me një portofol të pasur të aktiviteteve dhe impaktin e tyre të mrekullueshëm në këtë fushë, ka shfaqur sukses në aplikimin dhe përmbushjen e kriterëve të FIVA për të qenë anëtare me të drejta të plota në këtë federatë ndërkombëtare.

Anëtarësimi i Retro Albania në FIVA është një hap madhështor përpara që jo vetëm shënon një sukses të vërtetë për komunitetin e mjeteve historike në Shqipëri, por gjithashtu ndez dritën ndërkombëtare për trashëgiminë e pasur historike të automobilizmit në vendin tonë.

Kjo ngjarje paraqet një rast për të përhëndetur dhe nderuar përpjekjet dhe pasionin e të gjithë atyre që kanë punuar për të promovuar dhe ruajtur trashëgiminë historike të automobilizmit në Shqipëri.

KOLEKSIONI I PULLAVE POSTARE RETRO

Një Ekspozitë që rihap Historinë e Automobilizmit Shqiptar


Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe Posta Shqiptare kanë hapur një kapitull të ri në historinë e Shqipërisë, duke zbuluar një koleksion tërheqës të pullave postare me temë automobilistike. Kjo iniciativë ka qenë pjesë e projektit të shquar Retro Albania, që synon të promovojë trashëgiminë historike të automobilizmit shqiptar.

Në një event të mbajtur në Muzeun e Pullës Shqiptare për të festuar 110-vjetorin e Pullës Postare Shqiptare, koleksionistë, entuziastë dhe adhurues të historisë së automobilave u mblodhën për të dëshmuar këtë ngjarje të rëndësishme. Koleksioni i pullave postare me motive nga historia e automobilizmit është rezultat i përpjekjeve të vazhdueshme të autoriteteve për të nderuar dhe ekspozuar trashëgiminë kulturore dhe kombëtare.

Nga Tetori 2023, këto pulla me temë automobilistike janë në dispozicion për blerje në të gjitha Zyrat Postare në vend. Kjo është

një mundësi për të përzgjedhur një pullë me motive të mjetit historik shqiptar për çdo dërgesë postare, duke e bërë këtë koleksion një pjesë të jetës së përditshme.

Lançimi i kësaj serie pullash, jo vetëm nderon historinë e automobilizmit shqiptar, por gjithashtu paraqet një xhevahir të shtuar për të pasuruar kujtesën tonë kombëtare me këto objekte të rralla dhe historike.



SIMPOZIUMI I FIVA:

“Partneriteti dhe bashkëpunimi me Qeverinë dhe institucione të tjera”, për herë të parë në Shqipëri.



Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe RETRO Albania organizuan për herë të parë në bashkëpunim me Federatën Ndërkombëtare të Mjeteve Historike (FIVA), simpoziumin “Bashkëpunim dhe partneritet me Qeverinë dhe institucionet e tjera” në datën 29 Prill 2023, në zemër të Tiranës.

Përzgjedhja e Shqipërisë si vendi mikpritës në organizimin e këtij simpoziumi, erdhi pak muaj pas anëtarësimit të shumëpritur të RETRO Albania në FIVA në Nëntor 2022. Tashmë Shqipëria konsiderohet si një shembull për politikën lehtësuese për importin dhe regjistrimin e mjeteve që plotësojnë kriteret për statusin RETRO, ku mjetet që fitojnë këtë status në Shqipëri përfitojnë 90 ditë qarkullim në vit e pa detyrime taksash për mjetin, duke nxitur koleksionistët të pasurojnë Regjistrin

e Mjeteve RETRO si një vlerë e trashëgimisë kulturore dhe historisë së automobilizimit që do të flasë ndër breza.

Një takim i cilësuar nga Presidenti i FIVA Z. Tiddo Bresters dhe pjesëmarrësit si një eksperiencë e jashtëzakonshme, e organizuar në detaje për të përcjellë më së miri dhe Moton e FIVA, “Të mbrojmë trashëgiminë tonë: E ardhmja i përket atyre që kanë njohuri mbi të shkuarën e tyre”. Ndarja e eksperiencave, këshillave, sfidave nga ekspertë ndërkombëtarë, studiues, lider të industrisë, përfaqësues qeveritar, e kaloi forumin e mbajtur në një nivel tjetër më emocionues sepse u dhanë ide për të eksploruar strategji për të nxitur partneritete dhe bashkëpunime midis sektorëve publikë dhe privat.

Blendi Gonxhja, Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimeve të Transportit Rrugor, në fjalën

e mirëseardhjes për të gjithë pjesëmarrësit, theksoi rëndësinë e ruajtjes dhe të zhvillimit të këtij misioni.

“Falënderoj qeverinë shqiptare për suportin e pakursyer si dhe presidentin e FIVA-s, i cili pati besimin që Shqipëria do t’ia dilte këtij procesi, duke e afirmuar ‘Retro Albania’, si një ndër anëtarët e saj me të drejta të plota”, u shpreh Gonxhja.


Ndërsa, Ministrja e Kulturës, Elva Margariti dhe Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj theksuan kënaqësinë e të paturit të një komuniteti të zyrtarizuar dhe njohur ndërkombëtarisht për Mjetet Historike Shqiptare, për rëndësinë e tyre në zhvillimin e turizmit dhe ekonomisë vendase.

29 Prill 2023, Tiranë



KOLEKSIONI I MJETEVE HISTORIKE RETRO 2023

Modelet që i janë shtuar Regjistrimit Zyrtar të Mjeteve Historike në vitin 2023



Qershor 2020- Nëntor 2023

788
Verifikime
në total

576
Mjete që
plotësojnë
kriteret për
statusin Retro

112
Seanca
Verifikimi

21
Mjete historike
të Ministrisë së
Kulturës (ish
Kinostudio)

Mjete të verifikuara sipas qyteteve:

Tiranë	429
Durrës	51
Elbasan	16
Fushë-Krujë	4
Vlorë	55
Fier	18
Lushnjë	18
Korçë	6
Pogradec	4
Kavajë	30
Shkodër	100
Lezhë	2
Sarandë	15
Laç	6
Berat	16
Përmet	8
Gjirokastër	4
Kukës	2
Dibër	4

Janar-Nëntor 2023

177
mjete në
komision

132
kanë marrë
statusin

24
Seanca
Verifikimi

Mjete të verifikuara sipas qyteteve:

Tiranë	144
Elbasan	2
Vlorë	7
Fier	4
Lushnjë	4
Shkodër	13
Berat	2
Dibër	1

Mjete të pajisura me targa Retro: 133

Motomjete	45
Automjete	88

Mjete të pajisura me targa Retro: 564

Motomjete	243
Automjete	321



Zlombol Rally 2022



KUR TARGAT RETRO UDHËTOJNË DREJT AUSTRISË!

Klaudio Demiri, një i apasionuar i padiskutueshëm i mjeteve historike, ka udhëtuar drejt Wörthersee, Austrisë, me xhevahirin e tij të vjetër, Audi 100LS, i prodhuar në vitin 1973. Kjo është një aventurë e veçantë për t'u bërë pjesë, një event oltimer me makina historike, duke eksploruar e shëtitur me targa të koleksionit shqiptar retro. Për retroistët e pasionuar, kjo është një shenjë e qartë se mjetet me statusin Retro kanë mundësinë të kalojnë kufirin e Shqipërisë për të marrë pjesë në evente të rëndësishme oldtimer apo për të udhëtuar në destinacione të tjera të bukura të botës.

Është e rëndësishme të theksohet se për këtë lloj udhëtimi, që përfshin kufijtë, mjeteve duhet të pajiset me leje qarkullimi ndërkombëtare (kartoni me afat 3-vjeçar) dhe siguracion ndërkombëtar (karton jeshil). Kjo lejon lëvizjen pa problem në rrugët e vendeve të tjera dhe pjesëmarrjen në evente të rëndësishme oldtimer nëpër botë.

Udhëtimet e tilla sjellin një frymë të re për komunitetin e retroistëve dhe e bëjnë

të qartë se pasioni për mjetet historike nuk njih kufij, duke hapur dyert për aventura dhe emocione "vintage" në rrugët e botës. Këto udhëtime jo vetëm që shfaqin elegancën dhe bukurinë e mjetit historik, por gjithashtu rrisin ndjenjën e bashkësisë dhe përkushtimit ndaj trashëgimisë së çmuar të automobilizmit. Aventurat e këtilla tregojnë se rrugët e botës janë gjithmonë më tërheqëse kur udhëtohet me një pjesë të historisë së makinave.



"Udhëtimi i Gentian Bicit jashtë kufijve të Shqipërisë me makinën e tij të preferuar, Volkswagen T2 të vitit 1973, ishte një përvojë e paharrueshme për të."

Duke filluar nga Maqedonia e Veriut dhe drejtuar drejt Shqipërisë, ai përjetoj një udhëtim aq shumë të dëshiruar. Në rrugën e tij, ai ndeshi shumë makina ikonike të periudhës së komunizmit, duke shtuar ende më shumë në ndjesinë e kthimit në kohë. Takimi me mikun e tij, Michael, në kufirin mes tyre, i shtoi edhe më shumë ngjyrë udhëtimit të tij.

Genti ndihej i privilegjuar që kishte mundësinë të shihte nga afër dhe të përjetonte emocionin e makinave të prodhuara në kohën e komunizmit si Zuk, Nysa, Trabant dhe të tjera. Ndjenjat e tij të emocionuara dhe pasioni për këto makina e epokës u bënë gjithnjë e më të forta sa më afër arrinin eventit në Kavajë.

Rrugëtimi i tij përfundoi në plazhin e mrekullueshëm të Kavajës, ku rreth 900 makinat retro të periudhës së komunizmit krijuan një pamje të jashtëzakonshme. Çdo mjet kishte historinë e tij unike dhe emocionuese për të ndarë me të tjerët.

SHOQERIA KOLEKTIVE E AUTOMOBILAVE "MORAVA"

E kompletuar me automobila gjilgjerë të vitit 1970-1980 dhe kamione transportimi të reja. Garanton gjithë klientët për shërbimet e kënaqësme që do t'ju sjellë nënshkrimin e regullatave që ka Korçë Bilisht Follorinë, Korçë Pogradee Elbasan Peqin Kavajë Durrës Tiranë etj.

Tecmërisht çdo 15 Ditë udhëtojnë naturat Ilukse drejt për Selenik, dhe kurdo herë që efaqen udhëtarë ka çdo ditë. NGA DIREKSIA E SHOQËRISË



MIRË SE VINI NË RETRO, KOLEKSIONI SHQIPTAR

Platforma RETRO: Dashuria për mjetet historike në një ambient virtual, një univers ku arti, teknologjia dhe dizajni bashkohen për të çliruar kreativitetin dhe pasionin për këto trashëgimi të paharrueshme. Koleksionuesit dhe restauruesit gjejnë këtu një shtëpi, një burim informacioni dhe një komunitet që bashkëndan dashurinë për mjete me histori. Regjistrohu dhe zhytu në botën tonë virtuale të kujtesës së mjeteve të kaluara!



Çmimi: 5 GROSHE



www.retro.al



DPSHTRR

www.dpshttr.gov.al